



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:069645

Datë: 07.06.2021

Numri i dokumentit: 01857386

C.nr.1008/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ardian Ajvazi dhe zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen juridike të paditësit A.R nga fshati "..."-Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Leutrim Ademi nga Mitrovica Rr."Afrim Zhitia", kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara me adresës Rr."Rexhep Bislimi" në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson Armend Hysa, për shkak të kompensimit të shujtave, vlera e objektit të kontestit 662.00 Euro, me datë 17.05.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.R nga fshati "..."- Ferizaj dhe DETYROHET e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj Rr."Rexhep Bislimi" pn që t'ia paguaj paditësit në emër të kompensimit të shujtave shumë prej **662.00 Euro** (për periudhën nga data 18.04.2017 deri më datën 11.03.2020 për 331 ditë pune nga 2.00 Euro në ditë), me kamat prej 8% nga data e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 260.00 Euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 16.06.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e shpenzimeve të shujtave.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij theksoi mbesim në tërësi pranë padisë dhe parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën e fundit deklaroi se konsiderojë të pa qëndrueshme pretendimet e palës së paditur sa i përket mungesës së mjeteve buxhetore për shkak se kjo nuk bie në barrë të palës paditëse e për këtë arsye gjykatës i propozojë që të aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ta detyroj të paditurën që përveç detyrimit kryesor ta paguaj kamatën ligjore dhe shpenzimet e shkaktuara procedurale të cilat janë precizuar në parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë.

E paditura përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi, këshilli drejtues i Universitetit me vendimin numër 766/20, te datës 02.03.2020, ka

refuzuar kërkesën e sindikatës përkatësisht paditësit për kompensimin e shujtës ushqimore me arsyetim se në buxhetin e Universitetit nuk ka pasur mjete financiare të destinuar për këtë kategori, si dhe kërkojmë nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon si të pa bazë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendje faktike të kësaj çështje, për aq sa palët ndërgjyjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sër provash: Kontratën e punës e datës 14.08.2018, përmes së cilës vërtetohet fakti se paditësi tek e paditura është e punësuar në pozitën Profesor asistent; kërkesa e datës 28.02.2020, përmes së cilës paditësi i është drejtuar të paditurës edhe në procedurën administrative për kompensimin e shujtës ditore, vendimi i datës 02.03.2020, përmes së cilës refuzohet kërkesa për kompensimin e shujtës ditore për shkak se USHAF nuk ka mjete financiare të destinuar në buxhet për kompensimin e këtyre kategorive dhe vërtetimi i datës 20.11.2020, përmes së cilës vërtetohet se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga viti 01.10.2018 e tutje si dhe për periudhën 18.04.2017 deri më datën 11.03.2020 ka 331 ditë pune.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata konstatoj se ndërmjet palëve nuk ishin kontestuese faktet se paditësi është i punësuar tek e paditura në pozitën përkatëse siq i elaboruam më lartë. Gjykata vlerëson se paditësit i takon e drejta e ushqimit ditore bazuar në nenin 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Paditësi ka të drejtë në ushqim ditore në shumën prej 2 Euro, pra për një ditë të pranisë në punë. Paditësit i takon shuma prej 662.00 Euro në emër të shujtave ditore për 331 ditë të pranisë në vendin e punës, ky fakt me rëndësi është vërtetuar përmes vërtetimit të lëshuar nga e paditura përkatësisht Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Gjykata vlerëson se nuk kanë bazë juridike pretendimet e të paditurës se në mungesë të mjeteve financiare të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, për arsye se një detyrim i tillë i të paditurës vjen si rezultat i nënshkrimit të kontratës kolektive të datës 18.04.2017 me palë nënshkruese Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut.

Baza ligjore: Ligji i Punës nenet 10; 55 dhe 90, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nenet 22; 24; 31; 32; 49 dhe 54, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore neni 6 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë neni 35.

Gjykata sa i përket kamatës është bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës është bazuar në nenin 452 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve dhe atë: 104.00 Euro për parashtrimin e padisë; 135.00 Euro për një seancë të mbajtur dhe taksën për padi në shumën prej 21 Euro.

Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.1008/20, me datë 17.05.2021

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.